

Numri i lëndës: 2022:132249

Datë: 26.01.2024

Numri i dokumentit: 05245985

P.nr. 274/2022

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Dega V., Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtares së vetme gjyqese Blerina Jakupi Ramadani, me bashkëpunatorin profesional Fitim Limani, në çështjen penale ndaj të pandehurit Q.L.nga fshati G. Komuna V., për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i përgjithshëm, PP.II.nr.926/2022, e datës 24.06.2022, konform nenit 357 paragrafi 1, nenparagrafi 1.3 të KPPRK-së, jashtë seancës me datë 26.01.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurit Q.L.nga fshati G. Komuna V., për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe **HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.926/2022, e datës 24.06.2022 për shkak se i pandehuri është i vdekur.

E dëmtuara APK, zyra në V. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës paguhen nga mjetet buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i përgjithshëm, ka paraqitur në gjykatën Themelore në Gjilan, Dega në V., aktakuzën PP.II.nr.926/2022, e datës 24.06.2022, ndaj të pandehurit Q.L.nga fshati G. Komuna V., për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-së.

Nga Instituti i Mjekësisë Ligjore në Prishtinë sipas kërkesës së gjykatës është dorëzuar çertifikata e vdekjes në fotokopje në emër të Q.L.nga fshati G. Komuna V., i lindur me datë 08.04.2000.

Me parashtrësën e datës 11.01.2024 gjykata ka kërkuar nga Stacioni Policor në V. që të verifikohet personi Q.L.nga fshati G. Komuna V., se a ekziston edhe ndonjë person tjetër me këto shënime, pasi që në gjykata ekzistojnë edhe lëndë të tjera ndaj Q.L.nga fshati G. Komuna V., mirëpo me ditëlindje të ndryshme dhe zyrtarët e Stacionit Policor në V. me datë 26.01.2024 në gjykatë kanë dorëzuar parashtrësën, me të cilën e kanë njoftuar gjykatën se Q.L.ka vdekur në aksident trafiku, duke i bashkangjitur edhe çertifikatën e vdekjes lëshuar nga IML në Prishtinë. Si dhe në bazë të informatave që kishin me familjarët, nuk ekziston person tjetër me këto të dhëna.

Andaj, gjykata në pajtim me nenin 357 paragrafi1, nënparagrafi 1.3 të KPPRK-së si dhe duke marrë parasysh se i pandehuri Q.L.nga fshati G. Komuna V. është i vdekur, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-dega V.
Departamenti i përgjithshëm
P.nr.274/2022, me datë: 26.01.2024

Gjyqtarja,
Blerina Jakupi Ramadani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 3 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.